



e Rahovecit

Rritet subvencionimi për çdo lindje në 600€

Kryetari Latifi nënshkroi vendimet e para për subvencionimin e dy lindjeve në QKMF «Dr. Fahredin Hoti» në Rahovec. Nga ky vit, Komuna e Rahovecit do të subvencionojë lindjet në repartin e maternitetit të QKMF-së «Dr. Fahredin Hoti», nga 500€ sa ishte më parë, në 600€.



Miratohet raporti i dëmeve nga reshjet e shiut (5-7 janar 2026)

Pas vlerësimit dhe verifikimit në terren, në Kuvend u miratua njëzëri raporti për dëmet e shkaktuara nga reshjet e shiut të datave 5, 6 dhe 7 janar 2026. Raporti është hartuar me të dhëna reale nga komisionet komunale dhe kërkesat e qytetarëve, duke reflektuar seriozitetin e procesit.} Raporti do t'i dërgohet komisionit qeveritar për vlerësimin e dëmeve, me kërkesë për dëmshpërblimin e qytetarëve të prekur, ndërsa dëmet në infrastrukturë publike do t'i përcillen MMPHI-së për përkrahje në sanim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E RAHOVECIT
MUNICIPALITY RAHOVEC
OPŠTINA ORAHOVAC



RAPORTI I DËMEVE NGA RESHJET E SHIUT MË 5, 6 DHE 7 JANAR 2026

NR.	PËRSHKRIBJE	NR. KËRKESAVE	VLERË E DËMIT
1	LISTA E DËMEVE NË KUKUJIN SHALLAM	218	294,127.00€
2	LISTA E DËMEVE NË BUKËN	128	155,179.00€
3	LISTA E DËMEVE NË BUKËN	7	100,130.79€
4	LISTA E DËMEVE NË INFRASTRUKTURË PRIVATE	8	23,574.00€
5	LISTA E DËMEVE NË INFRASTRUKTURË PUBLIKE	27	129,885.00€
VLERË TOTALE E DËMEVE		410	803,895.79€

Nderohen dëshmorët e rënë në «Flakën e janarit»

Në Rahovec, në 36-vjetorin e rënies heroike të dëshmorëve Nesimi Elshani, Agron Fetahu, Halim Hoti dhe Hilmi Krasniqi, u bënë homazhe te vendi i rënies në Brestoc, si dhe u shënua një manifestim kulturor në qendrën e kulturës «Mensur Zyberaj».

Manifestimi u pasurua me poezi, me këngë e me valle nga nxënës dhe Sh.A. «Bajram Curri», si dhe me shpalljen e fituesve të konkursit të krijimtarisë letrare, duke ruajtur gjallë kujtesën e Flakës së janarit.

